



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 489 /2017  
Datë: 25 shtator 2017

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 3 paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-0224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 11 të Rregullores Nr.02/2015 për Zgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 25 shtator 2017, mori këtë:

**VENDIM**

- I. Rishpallet konkursi publik për anëtarin e Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Shoqërisë Civile.
- II. Kandidatët e propozuar për pozitën e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Shoqërisë Civile duhet të plotësojnë kriteret e parapara ligjore.
- III. Konkursi publik do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.
- IV. Konkursi do të shpallet në gazetatat e përditshme të Kosovës si dhe në faqen zyrtare të KPK-së.
- V. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të KPK-së.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

**Blerim Isufaj**  
Kryesues i Këshilli Prokurorial të Kosovës

Ti dërgohet:

- Sekretariatit;
- Arkivit të KPK-së.